

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit “Ndërtimi i zyrave të reja të drejtorisë së përgjithshme të shrukd-së” (kontratë me çelsa në dorë).

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Punë ndërtimi 45000000-7

Burimi i financimit: Fondet e SHRUKD sh.a

Financimi do të bëhet për një periudhë 3 vjeçare përkatësisht vitet 2025, 2026, 2027

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar Kapitulli 4.4 te DST-ve “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” Grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim gjykoj që vlerësimi të bëhet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanisë	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit	pikët 5

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [0-20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]
 - I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].
 - II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [0-15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin

2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të vecante të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecante të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecante të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënesi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shenim: Per permbushjen e kriterit te mesiperm operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

*Shënim – Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret) duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në pikën 1, nenin 83, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në pikën 1, neni 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 80 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024 të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024** lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e mësipërme i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetet financiare-ekonomike për të përmbushur me sukses objektin e prokurimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuargjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1 /a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
- Fatura tatimore perkatese.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas kërkesave më sipër të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *”Në lidhje me*

aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e hapjes së ofertave të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave të mesiperme të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qënë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qënë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE-ve në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotësuar sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera

përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-1 C** Punime gërmimi në toke;
- **NP-2 C** Ndërtime civile dhe industriale
- **NP-7 C** Ujesjellesa, Gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- **NP-10 C** Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energji elektrike
- **NP-12 C** Punime të Inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **NS-1 C** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **NS-2 C** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre.
- **NS-3 C** Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- **NS-4 C** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-8 C** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- **NS-9 C** Punime strukturore speciale
- **NS-12 C** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- **NS-13 B** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
- **NS-14 C** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- **NS-16 A** Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.
- **NS-17 A** Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.
- **NS-18 B** Punime topogjeodezike.
- **NS-19 B** Sisteme kundër zhurmes për infrastrukture
- **NS-20 A** Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre) muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë liçencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e liçensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje

nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik është një kërkesë e bazuar në ligj dhe në aktet nënligjore të tij.

2.3.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kategoria III.2.B” (Për Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe i mbetjeve nga pastrimi i ujrave te zeza urbane), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, si “Transport dheu dhe mbeturinash me auto deri në 10 km”, etj.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeoinformatik

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku

përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë **Projekt Idenë Përfundimtare** si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin arkitektonik.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve që përfshin kuota dhe piketime lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinier Gjeoinformatik** mund të përdorë teknologji të avancuara ose skanimin 3D për të krijuar modele të sakta të terrenit ku do të ndërtohet objekti. Sistemet kompjuterike të përdorura nga Ing. gjeoinformatike, mund të analizojnë karakteristikat gjeologjike dhe mjedisore të terrenit për të përcaktuar nëse toka është e përshtatshme për ndërtim dhe për të planifikuar masat për menaxhimin e rreziqeve (si p.sh., rrëshqitjet e dheut ose përmytjet). Kjo mund të ndihmojë për të parë më mirë ndikimin e projektit në mjedis dhe për të identifikuar probleme potenciale që mund të lindin gjatë ndërtimit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, të disponojë si staf mbështetës (jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë) të vertetuar me kontrate pune të

vlefshme, diplomë përkatës, CV si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqerise minimumi per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht

- 1 Arkitekt
- 1 Inxhinier ndërtimi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes, kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve, te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK, si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit te objektit.

- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve sipas parashikimeve në projektin arkitektonik dhe zgjidhjet arkitektonike.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kete si staf mbështetës (me kontrate pune/ kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- Kontratat individuale te punes (tëvlefshme)/kontratë bashkëpunimi, Diplomë /certifikatë / dëshmi kualifikimi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit ndihmës i është referuar projekt idese.

- **1 (një) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime në Ndertesa** është i domosdoshëm pasi për objektin që do të nënshtrohet punimeve për ndërtim apo rikonstrukcion do të nevojitet Studimi për Eficencën e Energjisë.
- **1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) në fazën e realizimit të projektit të zbatimit.
- **Eksperti zjarrfikës** është i domosdoshëm të jetë prezent në fazën e realizimit të projektit të zbatimit të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vlerësimeve përkatëse të fushës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi ose të kontrakttojë me kontratë bashkëpunimi një shoqëri projektuese të licencuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
Kat.2. Projektues Arkitekt	a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike;	<i>Projektim arkitektonik i godines qe do te rikonstruktohet dhe ambienteve ndihmese qe do te ndertohen etj.</i>
	b-2 qendra tregtare; objekte social- kulturore; objekte kulti; objekte arsimore;	<i>Projektim arkitektonik i godines qe do te rikonstruktohet dhe ambienteve ndihmese qe do te ndertohen etj</i>

	d- projektim peisazhi, sistemim siperfaqe të gjelbera, lulishte e parqe;	<i>Projektim i sistemimeve te jashtme</i>
Kat.3 Projektues Konstruktor	a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	Projektim i strukture beton arme per ambientet e reja qe do te ndertohen, me lartesi deri ne 3 kate.
Kat. 4. Projektues Instalator	a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;	<i>Realizimi i projektimit per instalimet hidro termo sanitare te godines</i>
	b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;	<i>Projektimi i impianteve te ngrohje ftohjes te godines.</i>
	c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;	<i>Projektim i rrjeteve elektrike dhe sistemeve elektrike te godines.</i>
	f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;	<i>Projektim i sistemeve te mbrojtjes nga zjarri, me sisteme qendrore hidraulike apo me bombula.</i>
	h- Projektimi i impianteve ngritese e transportuese (ashensore, shkalle levizese, etj.);	<i>Projektim i ashensoreve, ne godine kryesisht ne funksion te personave ne nevoje.</i>
	j- Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.	<i>Projektim i sistemeve te alarmit dhe detektimit te tymit, sistemeve te internet telefonise per krijimin e laboratoreve kompjuterike etj. Cdo instalim tjeter i telefonise, fonise, access kontroll ne keto kategori objektesh</i>
Kat 8. Projektues gjeodet	a- Rilevime inxhinierike	<i>Rilevime inxhinierike per efekt te aplikimeve per leje ndertimi apo procedurave te ngjashme te parashikuara ne projektimin e godines se shkolles</i>
Kat. 9. Studim Gjeologo	a) Studim/vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte	<i>Projektim Studim/vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per ndertimin e godines.</i>

Inxhinierik-Hidrogeologjik	civile - ekonomike deri ne 5 kate	
Kat. 12. Studime te Sizmologjise Inxhinierike	b) Studim/vleresim gjeologo-sizmike per trojet ku ndertohen objekte civile, sociale e kulturore	<i>Projektim Studim/vleresim gjeologo-sizmik i truallit per ndertimin e godines.</i>

Sqarim: Per licencat e e lëshuara pas hyrjes ne fuqi te Vendimit nr. 943, date 28.12.2016 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 759, date 12.11.2014, te këshillit te ministrave “Per licencimin profesional te individëve dhe personave juridike qe do te ushtrojnë veprimtari ne fushën e studimit e projektimit ne ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit te punimeve te zbatimit ne ndërtim”. Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet te paraqesë licenca profesionale te shoqërisë (e vlefshme) per projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione te tjera te autorizuar sipas legjislacionit ne fuqi per dhënien e licencave profesionale ne fushën e studim-prjektimit ne ndërtim), e vlefshme, ku te përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse ne emertese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (nje) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë* si dhe për *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kërkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune
Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per minimizin e aksidenteve ne pune.

2.3.11 Një punësim minimalisht prej 100 (njqind) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per tre muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per tre muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per per tre muajt e fundit te deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit te tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 100 punonjes duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për

kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min **100 punonjes**.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Hidraulik	2 (dy)
- Elektracistë	3 (tre)
- Hekurkthyes	4 (kater)
- Karpentier	3 (tre)
- Hidroizolues	2 (dy)
- Muratorë/betonues	3 (tre)
- Suvatues	1 (nje)
- Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to	1 (nje)
- Punonjës duro-alumini	4 (kater)
- Bojaxhi	3 (tre)
- Eskavatorist/manovrator	2 (dy)
- Shofer për kamion	3 (tre)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.13. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018/ekuivalente, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.

Shënim: Për certifikatat e mësipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.13 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin.

AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

2.3.14. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbi 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet 3-5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamion vetshkarkues 4 Akse 20 ton	cope	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me zinxhire	cope	1	Në pronësi ose me qera
6	Vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Fadrome	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Depozite uji deri ne 5000 litra	cope	1	Në pronësi ose me qera
9	Pompe Suvatimi	cope	1	Në pronësi ose me qera

10	Makineri per prerje hekur ndertimi	cope	1	Në pronësi ose me qera
11	Makineri per kthim hekur ndertimi	cope	1	Në pronësi ose me qera
12	Elektrosaldatrice	cope	1	Në pronësi ose me qera
13	Vibrator	cope	2	Në pronësi ose me qera
14	Betonjere 500 lit	cope	1	Në pronësi ose me qera
15	Paisje niveluese për nivelim shtresash	cope	1	Në pronësi ose me qera
16	Pompë uji	cope	1	Në pronësi ose me qera
17	Skela	m2	750 m2 (min)	Në pronësi ose me qera

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- c. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

1. Kamion me kapacitet mbi 10 ton. Prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit.
2. Kamion me kapacitet 3-5 ton prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe për transportin e materialeve të ndryshme të ndërtimit, hidraulike elektrike etj ku mjeti është i favorshen pasi mund të qarkullojë në territor pa orar.
3. Kamion veteshkarkues 4 Akse 20 ton prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe për transportin e materialeve të ndryshme të ndërtimit.
4. Eskavator me goma prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zërin Germim dheu.
5. Autovinc prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për ngritjen e materialeve, paisjeve të ndryshme, montim të materialeve të tjera në lartësi.
6. Gjenerator- prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo pajisje është e domosdoshme për sigurimin e energjisë elektrike në rastet e mungesës së saj.

7. Betoniere - prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, përgatitjen e sasive të vogla të betonit.
8. Pompë suvatimi- prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për punimet e suvatimit.
9. Depozite uji (kapaciteti minimal 5000 litra) prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për punimet e betonit, suvatimit, etj.
10. Vibrator prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit.
11. Makineri për prerje hekur ndërtimi – nisur nga fakti që në zerrat e preventivat janë parashikuar punime hekuri ndërtimi.
12. Makineri për kthim hekur ndërtimi– nisur nga fakti që në zerrat e preventivat janë parashikuar punime ndërtimi kthim hekuri .
13. Elektrosaldatrice – nisur nga fakti që në zerrat e preventivat janë parashikuar punime ndërtimi kthim hekuri .
14. Fadrome - prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit.
15. Pompë uji- prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, për zerrat që kanë punime betobi, llaci, suvatimi etj
16. Paisje niveluese për nivelim shtresash -prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, për zerrat që kanë punime shtresash etj.
17. Skela -prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, për realizimin e të gjitha punimeve të fasades dhe në lartësi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t'i certifikojnë me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, ofertuesi duhet të vërtetojë ligjërisht moslëshimin e tyre nga institucione përkatëse të vendit të origjinës.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projekt idene, bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë Autoriteti Kontraktor dhe të hartuara nga projektuesi.